



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE, NATYRORE
PRISHTINË

Pranuar me:	20.06.2022		
Ni. org.	Numeri	Skeda	Vlera
01	3296	4	-

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

Fakulteti
Lëndët

Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
Grup lëndësh nga Kimia Organike (pozita 13 FSHMN)

Kandidatët e paraqitur

1. Veprim Thaçi
2. Mimoza Koskoviku
3. Arbër Musliu

Komisioni vlerësues

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof. Dr. Fatbardh Gashi
Prof. Assoc. Dr. Ramiz Hoti
Prof. Dr. Ramë Vataj



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

SHËNIMET PËRMBLEDHËSE TË KANDIDATËVE

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Applikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjëratë			Applikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime			Moshë (datëlindja)	Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet)	Bie ndesh me Nenin 7, paragrafi 10, Rregullorja Nr. 1/95, e datës 24/06/2021 (PO/JO)	Propozohet të angazhohet (PO/JO)
			Thirrja akademike	Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me kriteret e Statutit dhe Rregulloren në fuqi për emërimin e personelit akademik	Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë)	Nota Ba.	Nota Ma.	Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë				
1.	Veprim Thaçi	Msc.	Ass.	20	///	8.43	9.18	24.10.1981	13 vjet		Po	
2.	Wimoza Koskoviku	Msc.	///	///	///	8.94	9.35	15.02.1995	///		Jo	
3.	Arbër Musliu	Msc.	///	1	///	8.59	9.00	10-12-1995	///		Jo	



Vlerësim dhe propozim:

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të materialit të paraqitur nga kandidatët, komisioni vlerësues i emëruar me vendimin e Këshillit të FSHMN-së nr. 3029, të datës 08. 06. 2022, vlerëson dhe propozon:

Në konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm nr/1/217, dt. 01. 06. 2022 (FSHMN pozita 13) janë paraqitur tre kandidatë si në vijim:

1. **Ass. Msc. Veprim Thaçi**, i lindur më 24. 10. 1981 në Shkarashnik, studimet Bsc në drejtimin Kimi inxhinierike i ka përfunduar në vitin 2006 në Universitetin e Prishtinës (nota mesatare 7.64), ndërsa në vitin 2017 ka përfunduar studimet themelore në Universitetin e Tetovës me notë mesatare 8.43 dhe ka marrë gradën Profesor i diplomuar i kimisë. Në vitin 2009 ka përfunduar studimet e masterit në Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 9.18 dhe ka marrë gradën Master i shkencave të kimisë, programi Kimi organike dhe biokimi. Kandidati ka të regjistruara studimet e doktoratës në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodi" të Shkupit dhe aktualisht është në ciklin e tretë të këtyre studimeve. Në vitin 2011 kandidati është zgjedhur në thirrjen Asistent, ndërsa në vitin 2016 është rizgjedhur në këtë thirrje. Kandidati ka një përvojë rreth 12 vjeçare në Universitetin e Prishtinës dhe ka të publikuara 19 punime si autor i parë dhe koautor në revista të përfshira në platforma relevante dhe ka marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm të konferencave shkencore ndërkombëtare e vendore, si dhe ka kryer një numër të konsiderueshëm të trajnimeve (të dëshmuara me 13 certifikata). Kandidati Ass. Msc. Veprim Thaçi i plotëson të gjitha kriteret për angazhim sipas konkursit për pozitën 13 FSHMN.
2. **Msc. Mimoza Koskoviku**, e lindur më 15. 02. 1995 në Prishtinë, studimet Bsc në drejtimin Kimi inxhinierike i ka përfunduar në vitin 2016 në Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 8.84, ndërsa në vitin 2019 ka përfunduar studimet e masterit në Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 9.35 dhe ka marrë gradën Master i shkencave të kimisë, programi Kimi organike. Në vitin 2019 kandidata ka regjistruar studimet e doktoratës në Universitetin e Prishtinës. Kandidata ka një përvojë mbi pesëvjeçare në fushën profesionale në disa kompani private në Kosovë. Kandidatja Msc. Mimoza Koskoviku i plotëson kriteret formale për angazhim sipas konkursit për pozitën 13 FSHMN.
3. **Msc. Arbër Musliu**, i lindur më 20. 12. 1995 në Ferizaj, studimet Bsc në drejtimin Kimi i ka përfunduar në vitin 2017 në Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 8.59, ndërsa në vitin 2020 ka përfunduar studimet e masterit në Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 9.00 dhe ka marrë gradën Master i shkencave të kimisë, programi Kimi analitike dhe mjedis. Në vitin 2020 kandidati ka regjistruar studimet e doktoratës në Universitetin e Prishtinës. Kandidati ka të publikuar 1 punim si koautor në revistën Electroanalysis dhe ka marrë pjesë në dy konferenca shkencore. Në bazë të Rregullores 1/95, dt. 24. 06. 2021, neni 7 (alinjeja 3.1), kandidati Msc. Arbër Musliu nuk i plotëson kriteret për angazhim sipas konkursit për pozitën 13 FSHMN, meqenëse studimet e masterit i ka të përfunduara në lëminë joadekuate. Kandidati është propozuar si bashkëpunëtor për pozitën 14 FSHMN.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit Vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm



Duke u bazuar në dispozitat e Statut të Universitetit të Prishtinës (neni 178, alinea 1.1-4), dhe të rregullores Nr.1/95, datës 24. 06. 2021 (neni 7, alinea 3.1-4 dhe alinea 4.1), komisioni i propozon Këshillit të FSHM-së dhe Senatit të Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina, që kandidatin **Ass. Msc. Veprim Thaçi** t'a angazhojë si bashkëpunëtor për mbajtjen e ushtrimeve për grup tëndësh nga Kimia Organike.

Prishtinë,
20. 06. 2022

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE
PRISHTINË

Pranuar me:	20. 06. 2022		
Ni. org.	Numer	Sacia	Vite
01	3296	4	-

Komisioni Vlerësues:

1. Prof. Dr. Fatbardh Gashi 
2. Pof Assoc. Dr. Ramiz Hoti 
3. Prof Dr. Ramë Vataj 